



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al)

e-mail: [keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al](mailto:keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al)

**V E N D I M**

**Nr. 3, datë 30.1.2017**

**Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje  
për sezonin veror 2017**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.1.2017, me propozim të Kryetares së Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "e", të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 17 pika 4 e ligjit nr. 9693/2007 "Për fondin kullor" i ndryshuar, pika 48 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" Kreu II, pika 2 e Udhëzimit nr. 2, datë 20.7.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari",

**V E N D O S I**

1. Miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin veror 2017, sipas listës dhe hartave bashkëlidhur.
2. Për vazhdimin e procedurave sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 2, datë 20.7.2016 të Ministrit të Mjedisit ngarkohet Drejtoria e mjedisit, pyjeve dhe menaxhimit të ujrave në bashki.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.1.2017

Shpallur në datën 31.1.2017

**Sekretar i këshillit**

**Suel Hadri**



**KRYETAR**

**Xhemal BUSHATI**